FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 182

Tiranë – E enjte, 29 shtator 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 28.9.2016	Për lirim nga detyra	20841
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 28.9.2016	Për emërim në detyrë	20841
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 28.9.2016	Për lirim nga detyra	20841
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 674, datë 28.9.2016	Për emërim në detyrë	20841
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 677, datë 28.9.2016	Për lirimin dhe emërimin nga/në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave	20841
Udhëzim i përbashkët i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 515, datë 27.9.2016	Për përpunimin e të dhënave personale nga rojet kufitare	20842
Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 182, datë 20.9.2016	Për miratimin e rregullores "Për trajtimin e llojeve të faunës së egër në zooparqe dhe në mjedise të tjera, ku individët i ekspozohen publikut"	20844
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 64, datë 15.9.2016	Për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike	20849
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 65, datë 15.9.2016	Autorizim i dhënies së ndihmës shtetërore "Për nxitjen e punësimit në ndihmë të krijimit të biznesit social rinor"	20852
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 66, datë 15.9.2016	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për krijimin e fondit shqiptar të konkurrueshmërisë për periudhën 2016–2018"	20856

Vendim i Autoritetit të Mediave Audiovizive nr.183, datë 6.9.2016	Mbi një ndryshim në vendimin e AMA-s, nr. 6, datë 22.5.2013, "Mbi miratimin e pagesave për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive".....	20859
Vendim i Autoritetit të Mediave Audiovizive nr.210, datë 16.9.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 6, datë 22.5.2013, "Mbi miratimin e pagesave për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive".....	20859
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4505, datë 20.9.2016	Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Korçë–Ersekë (loti 1)" për pasuritë e llojit "arë".....	20859
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4594, datë 23.9.2016	Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tiranë–Elbasan Loti III (shtesa)" për pasuritë e llojit "arë", "drufrutorë" dhe "kultura bujqësore".....	20861
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4595, datë 23.9.2016	Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga rikonstruksioni i aksit rrugor "Shkodër–Mes" për pasuritë e llojit "truall" dhe "arë".....	20863
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4626, datë 26.9.2016	Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Nyja lidhëse Milot–Lezhë, Milot–Rrëshen, Milot–Thumanë" për pasuritë e llojit "objekt", "arë" dhe "kultura bujqësore".....	20865
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4627, datë 26.9.2016	Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Nyja Rrugore Vorë" për pasuritë e llojit "arë".....	20865
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 4041/2, datë 23.9.2016	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerim dhe rikonstruksion i bulevardit "Fan Noli", në Bashkinë e Korçës.....	20866
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 5113, datë 20.9.2016	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Kompleksi Sportiv Lushnja" qyteti Lushnjë.....	20867
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Feti Shyqyri Tarko.....	20867

VENDIM
Nr. 671, datë 28.9.2016

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ervin Mete, zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 672, datë 28.9.2016

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Briseida Shehaj të emërohet zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 673, datë 28.9.2016

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Irena Beqiraj, zëvendësministër i Financave, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 674, datë 28.9.2016

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ervin Mete të emërohet zëvendësministër i Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 677, datë 28.9.2016

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NGA/NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DOGANAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Pranvera Fagu, drejtor i Përgjithshëm i Doganave, lirohet nga kjo detyrë.

2. Znj. Belinda Ikonomi emërohet drejtor i Përgjithshëm i Doganave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 515, datë 27.9.2016

PËR[1] PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NGA ROJET KUFITARE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 71/2016, "Për kontrollin kufitar", ministri i Punëve të Brendshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZOJNË:

1. Rojet kufitare, në funksion të kontrollit kufitar, mbledhin të dhëna personale deri në atë masë sa është e nevojshme për identifikimin e saktë të personit që synon të kalojë, kalon apo ka kaluar kufirin, si dhe të dokumentacionit dhe mjetit të udhëtimit që ky person synon të përdorë ose përdor për të kaluar kufirin, së bashku me motivin e kalimit të kufirit, kohën dhe vendin e saktë kur dhe ku është synuar të kalohet apo është kaluar kufiri, me qëllim garantimin e sigurisë kufitare dhe sigurisë së brendshme, si dhe parandalimin, zbulimin dhe hetimin e rasteve të migracionit të paligjshëm dhe krimit ndërkufitar.

2. Rojet kufitare, në funksion të kontrollit kufitar, shfrytëzojnë të dhëna personale dhe konsultohen me to, deri në atë masë sa është e nevojshme për kryerjen e një kontrolli kufitar optimal, me qëllim garantimin e sigurisë kufitare dhe sigurisë së brendshme, si dhe parandalimin, zbulimin dhe hetimin e rasteve të migracionit të paligjshëm dhe krimit ndërkufitar.

3. Rojet kufitare, në përputhje me pikën 1, mbledhin dhe regjistrojnë të dhëna personale të:

a) shtetasve të huaj të refuzuar në hyrje të Republikës së Shqipërisë;

b) personave të refuzuar në dalje të Republikës së Shqipërisë;

c) shtetasve të huaj të cilëve në zbatim të pikës 4, të nenit 16, të ligjit nr. 71/2016, "Për kontrollin kufitar", nuk u vendoset vulë në dokumentin e udhëtimit;

ç) shtetasve të huaj që pajisen me vizë në kufi;

d) personave që pajisen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, ose që kalojnë kufirin, me dokumente që zëvendësojnë dokumentet e udhëtimit dhe vizat;

dh) personave të kthyer dhe të riatdhesuar nga autoritetet e huaja në Republikën e Shqipërisë, ose nga autoritetet shqiptare drejt një vendi tjetër;

e) personave që kanë kaluar ose tentojnë të kalojnë në mënyrë të paligjshme kufirin shtetëror;

ë) personave që paraqesin kërkesa dhe ankesa në kuptim të kontrollit kufitar;

f) personave që kryejnë kundërvajtje administrative nën juridiksionin e Policisë Kufitare dhe Migracionit;

g) personave që kryejnë vepra penale nën juridiksionin e Policisë Kufitare dhe Migracionit;

gj) personave që hyjnë dhe dalin në kufi, kur instrumentet elektronike ose arkivi elektronik i regjistrimit të hyrje-daljeve është jashtë funksionit për një kohë të gjatë, duke i depozituar të dhënat në një regjistër të përkohshëm shkresor.

4. Rojet kufitare, në përputhje me pikën 1, krahas të dhënave të parashikuara në pikën 3, mund të mbledhin dhe regjistrojnë, gjithashtu, dokumentacion që përmban të dhëna personale, si më poshtë:

a) intervistat e personave të kthyer dhe riatdhesuar në Shqipëri, si dhe të personave që kanë kaluar apo tentojnë të kalojnë kufirin në mënyrë të parregullt, kur këto janë të nevojshme për zbulimin e veprave penale dhe shkeljeve administrative apo identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit;

b) dokumentacion mbështetës për kalimin e kufirit, si: certifikata, ftesa, deklarata noteriale, kontrata etj.;

c) origjinalin ose kopjet e listave të udhëtarëve të mjeteve të transportit, që kanë detyrim plotësimin dhe paraqitjen e këtyre listave;

ç) foto dhe video të siguruara me anë të pajisjeve të kontrollit kufitar, kur këto pajisje e mundësojnë këtë manualisht ose automatikisht dhe të dhënat në fjalë janë të nevojshme për zbulimin e veprave penale dhe kundërvajtjeve administrative apo për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit;

d) foto dhe video nga kamerat e sigurisë dhe pajisjet e tjera, që janë instaluar, në ambientet e përdorura nga Policia Kufitare dhe e Migracionit për efekt të kontrollit kufitar.

[1] *Ky udhëzim është përafruar pjesërisht me Rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, "Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)", numri CELEX 32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.77, datë 23.3.2016, faqe 1–52.*

5. Rojet kufitare, për efekt të kontrollit kufitar, krahas të dhënave personale dhe dokumentacionit të parashikuar në pikat 3 dhe 4, konsultojnë dhe shfrytëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm që përmban të dhëna personale:

a) shënimet, njoftimet dhe informacionet e autoriteteve ligjzbatuese, të shfaqura automatikisht, ose me kërkim në sistemet elektronike, si dhe ato që mbërrijnë shkresërisht dhe që përcaktohen si të nevojshme të konsultohen dhe shfrytëzohen gjatë kontrollit kufitar;

b) arkiva elektronikë dhe shkresorë që me marrëveshje, me ligj ose me vendim të autoriteteve përgjegjëse, përcaktohen si të nevojshme të konsultohen dhe shfrytëzohen gjatë kontrollit kufitar.

6. Regjistrimet për verifikimet e vijës së dytë dhe ato për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit, kryhen vetëm mbi bazë statistikore që nuk mundëson zbulimin e të dhënave personale të subjekteve. Rregullat praktike për këto raste përcaktohen me procedura standarde të veprimit të Policisë Kufitare dhe Migracionit.

7. Mbledhja, regjistrimi, konsultimi dhe shfrytëzimi i të dhënave, të parashikuara në pikat 3 dhe 4, si dhe konsultimi e shfrytëzimi i të dhënave të parashikuara në pikën 5, kryhet në mënyrë të tillë që roja kufitare që i mbledh, i regjistron, konsultohet me to dhe/ose i shfrytëzon, si dhe punonjësi autorizues apo vendimmarrës për këto veprime të rojës kufitare, të jetë i identifikueshëm.

8. Të gjitha regjistrimet që kryhen në arkiva shkresorë nga rojet kufitare mund të regjistrohen në arkiva elektronikë, kur është marrë një vendim për krijimin e një arkivi të tillë nga autoritetet përgjegjëse.

9. Në rastet e parashikuara në pikën 8, arkivat shkresorë, të cilët regjistrohen në arkiva elektronikë asgjësohen sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga regjistrimi në arkiv elektronik. Arkivat e mëparshëm shkresorë, të cilët nuk regjistrohen ose nuk mund të regjistrohen në arkiva elektronikë, ruhen deri në afatin e parashikuar për anonimizim të pakthyeshëm sipas përcaktimeve të pikës 13 apo fshihen sipas përcaktimit të pikës 14.

10. Të dhënat e subjekteve të parashikuara në pikën 3, germa "gj", regjistrohen detyrimisht në arkivin elektronik të hyrje-daljeve brenda 5 ditëve kalendarike nga rivendosja në funksion e sistemit kompjuterik ku regjistrohen këto të dhëna, ndërsa regjistri shkresor në fjalë asgjësohet brenda 7 ditëve kalendarike nga kalimi i të dhënave në arkiv elektronik.

11. Rregullimet praktike për marrjen e vendimit për regjistrim në regjistër shkresor, mënyrën e këtij regjistrimi dhe mënyrën e kalimit në arkiv elektronik të të dhënave të parashikuara në pikën 3, germa "gj", si dhe për mënyrën e asgjësimit të regjistrit shkresor përkatës, përcaktohen me procedura standarde të veprimit të Policisë Kufitare dhe Migracionit.

12. Gjatë dhe për efekt të kontrollit kufitar, rojet kufitare konsultohen me dhe shfrytëzojnë drejtpërdrejt të dhënat e lartpërmendura, në bazë të nevojës për njohje, sipas afateve në vijim:

a) 2 vjet për arkivin elektronik të hyrje-daljeve;

b) 1 vit për të dhënat e përmendura në pikën 3, përveç germave "g" dhe "gj";

c) për aq kohë sa parashikohet në udhëzimin nr. 17, datë 11.5.2012, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germa "g";

ç) deri në kohën e asgjësimit të regjistrit, për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germa "gj";

d) 1 vit për të dhënat e përmendura në pikën 4, germat "a", "b" dhe "c";

dh) përgjatë gjithë kohës së memorizimit automatik ose manual që ofron pajisja përkatëse për të dhënat e pikës 4, germat "ç" dhe "d", por jo më shumë se 1 vit;

e) pa kufizim për shënimet dhe njoftimet aktive të parashikuara në pikën 5, germa "a";

ë) 3 muaj pas anulimit, revokimit ose përfundimit të afatit të vlefshmërisë së shënimeve dhe njoftimeve të parashikuara në pikën 5, germa "a";

f) përgjatë gjithë kohës së fuqisë ligjore të marrëveshjes, ligjit ose vendimit për aksesim, për të dhënat e parashikuara në pikën 5, germa "b".

13. Të dhënat personale të mbledhura nga roja kufitare, në përputhje me pikat 3 dhe 4, anonimizohen në mënyrë të pakthyeshme kur plotësojnë këto afate:

a) 2 vjet për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germat "a", "b", "ç", "d", "dh", "e";

b) 6 muaj për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germa "ë";

c) për aq kohë sa parashikohet nga ligji për kundërvajtjet administrative, për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germa "f";

ç) 1 vit për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germa "c" dhe për të dhënat e parashikuara në pikën 4;

d) për aq kohë sa parashikohet në udhëzimin nr. 17, datë 11.05.2012, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe aktet në zbatim të tij, për të dhënat e parashikuara në pikën 3, germa "g";

dh) 3 muaj pas përfundimit të afatit apo vlefshmërisë së veprimit të kërkuar në dokumentin shkresor, për të dhënat e parashikuara në pikën 5, germa "a";

e) 5 vjet për hyrjet dhe daljet e regjistruara në arkiv elektronik.

14. Nëse anonimizimi i pakthyeshëm, i parashikuar në pikën 13, është teknikisht i pamundur, të dhënat në fjalë fshihen përfundimisht.

15. Qendra për Përpunimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave, bazuar në të drejtën për njohje që jep legjislacioni ose marrëveshjet në fuqi, përcakton institucionet dhe strukturat që aksesojnë dhe shfrytëzojnë drejtpërdrejt të dhënat e mbledhura dhe regjistruara nga rojet kufitare në arkivat elektronikë, si dhe menaxhon përdoruesit.

16. Për rastet e çështjeve të veçanta, për të cilat një përdorues i caktuar kërkon, për shkak të detyrës, të aksesojë të dhënat përtej afatit të parashikuar të konsultimit dhe shfrytëzimit të drejtpërdrejtë për strukturën ku përdoruesi bën pjesë, kërkesa për akses, miratimi i saj, zbatimi dhe mbyllja e aksesit, përcaktohen me urdhër të drejtorit të Policisë së Shtetit.

17. Policia Kufitare dhe e Migracionit vendos në dispozicion të autoriteteve të tjera të dhënat e mbledhura prej saj, në kuptim të nenit 20, pika 1, germa "d", të ligjit nr. 71/2016, "Për kontrollin kufitar", vetëm në rast se këto të dhëna nuk, ose nuk mund të konsultohen dhe shfrytëzohen drejtpërdrejt nga autoriteti që i kërkon.

18. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson në mënyrë periodike, si dhe rast pas rasti, përputhshmërinë e të dhënave të përpunuara sipas parashikimeve të pikave 3,4 dhe 5, me qëllimin e përpunimit të tyre.

19. Subjektet e të dhënave personale të mbledhura dhe regjistruara nga rojet kufitare, në zbatim të ligjit nr. 71/2016, "Për kontrollin kufitar", të drejtën për t'u informuar e ushtrojnë nëpërmjet strukturave përgjegjëse të Policisë së Shtetit për informimin e qytetarëve, të përcaktuara me urdhër të drejtorit të Policisë së Shtetit.

20. Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin merr masat për zbatimin e afateve të parashikuara në këtë udhëzim për arkivat shkresorë.

21. Struktura përgjegjëse për teknologjinë dhe informacionin, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit merr masat për zbatimin e afateve të ruajtjes, aksesimit dhe anonimizimit të pakthyeshëm apo fshirjes së të dhënave personale që përpunohen në arkivat elektronikë për efekt të kontrollit kufitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

URDHËR
Nr. 182, datë 20.9.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR TRAJTIMIN E LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR NË ZOOPARQE DHE NË MJEDISE TË TJERA, KU INDIVIDËT I EKSPOZOHEN PUBLIKUT"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës "d", të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe në zbatim të nenit 26, pika 2, të ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008, "Për mbrojtjen e faunës së egër", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për trajtimin e individëve të llojeve të faunës së egër në zooparqe apo në mjedise të tjera, ku individët i ekspozohen publikut", sipas draftit që i bashkëlidhet këtij urdhri, si pjesë përbërëse e tij.

2. Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura dhe Drejtoria Juridike, e Komunikimit dhe Prokurimeve të dërgojnë urdhrin për botim pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, brenda 2 ditëve nga miratimi i tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka

RREGULLORE
PËR TRAJTIMIN E LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR NË ZOOPARQE DHE NË MJEDISE TË TJERA, KU INDIVIDËT I EKSPOZOHEN PUBLIKUT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Rregullorja "Për trajtimin e individëve të llojeve të faunës së egër në zooparqe dhe në mjedise të tjera, ku individët i ekspozohen publikut" ka si që qëllim të mbrojë faunën e egër dhe të ruajë biodiversitetin, nëpërmjet masave të inspektimit të aktivitetit të parqeve zoologjike (zooparqeve) në territorin e Republikës së Shqipërisë.

KREU II
MASAT RUAJTËSE (KONSERVUESE) DHE MIRËMBAJTJA E KAFSHËVE

Neni 2
Masat ruajtëse (konservuese) që duhet të zbatojnë zooparqet

1. Zooparqet duhet të zbatojnë një sërë masash ruajtëse (konservuese):

a) Të marrin pjesë në kërkime që do të çojnë në thellimin e njohurive, nga të cilat do të përfitojnë llojet; në trajnime për fushën e konservimit; në shkëmbimin e informacionit që lidhet me ruajtjen e llojeve dhe me shumimin në gjendje jo të lirë, ripopullimin dhe riintroduktimin (rifutjen) e llojeve në jetën e egër;

b) Të promovojnë edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut dhe në shkolla për ruajtjen e biodiversitetit, duke ofruar informacione specifike për llojet e ekspozuara, për habitatet natyrore, për mundësitë dhe opsionet për planifikimin e rifutjes së tyre në natyrë dhe në problematikat e konservimit të llojeve të ndryshme;

c) Të akomodojnë kafshët në kushte që synojnë të kënaqin kërkesat biologjike dhe ato të ruajtjes, duke siguruar rrethimin specifik sipas llojit dhe duke mbajtur një standard të lartë të kujdesit për to, nëpërmjet zhvillimit të një programi të kujdesit veterinar parandalues dhe kurativ, si dhe të ushqimit;

d) Të kenë lloje të shëndetshme dhe të përmbushin nevojat biologjike të tyre, të garantojnë mirëqenien e tyre dhe ruajtjen e llojeve, duke mundësuar edhe mbrojtjen e mjedisit;

e) Të sigurojnë mbajtjen dhe mbrojtjen e kafshëve nëpërmjet programeve dhe trajtimeve veterinare e kurative, duke ofruar një dietë të saktë;

f) Të marrin masa për të parandaluar largimin e kafshëve, në mënyrë që të shmangen kërcënimet ekologjike për llojet indigjene dhe të parandalohet përhapja e llojeve të huaja (invazive);

g) Të mbajnë dhe të përditësojnë *database*-n dhe regjistrin për të gjithë individët e çdolloji që gjenden në koleksionin e kopshtit zoologjik.

Neni 3
Mirëmbajtja e kafshëve, mirëqenia dhe shëndeti i tyre

1. Në zooparqe duhet të zbatohen rregullat e mëposhtme për të siguruar mirëqenien e kafshëve:

a) Vëzhgimi rutinë i kafshëve duhet të kryhet çdo ditë nga personeli i autorizuar;

b) Çdo lloj që paraqet situata stresi, është i sëmurë apo i plagosur, duhet t'i jepet ndihma e shpejtë dhe e specializuar nga mjeku veterinar;

c) Hyrja e vizitorëve në parkun zoologjik me mjete private lejohet vetëm në vendet e caktuara për parkim për të evituar shqetësimin e individëve në parqe.

KREU III
MJEDISI, USHQIMI, KUJDESI VETERINAR DHE PROTOKOLLI PAS NGORDHJES SË KAFSHËVE

Neni 4
Hapësira, nevoja për ecje dhe bashkëjetesa me lloje të tjera

1. Individët e llojeve të faunës së egër duhen vendosur në territore të rrethuara me gardhe, kafaze apo në vaska në mënyrë të tillë që të lejojnë

kryerjen e aktivitetit fizik, në bazë të përkatësisë llojore.

2. Gardhet, kafazet apo vaskat duhen dimensionuar në mënyrë efikase dhe llojet duhen menaxhuar, në mënyrë që:

a) Të evitohet që llojet të krijojnë grupe dominante, të cilat nuk i përkasin llojit;

b) Të evitohen konfliktet midis llojeve;

c) Të ndalohet infektimi i individëve nga parazitë të ndryshëm.

3. Individët nuk duhen provokuar për të pasur sjellje jashtë natyrës së tyre, për të përfituar argëtime nga ana e vizitorëve.

4. Shpërndarja e llojeve në territore të rrethuara me gardhe, kafaze apo në vaska të afërta me njëra-tjetrën bëhet në mënyrë të tillë që të mos bashkëveprojnë me njëri-tjetrin dhe të mos krijohet stres midis tyre.

5. Gardhet, kafazet dhe vaskat duhet të kenë hapësira të mjaftueshme dhe të ndara për femrat e mbarsura apo që kanë të vegjël në mënyrë të tillë që të evitohen situata të stresit apo të vuajtjes.

6. Largimi dhe izolimi i femrave të mbarsura apo i femrave më të vogla duhet të bëhet vetëm me lejen e veterinarit apo të përgjegjësit të parkut zoologjik.

Neni 5

Kushtet e mjedisit

1. Temperatura, ventilimi dhe drita e kafazeve duhet të jenë të përshtatshme për të siguruar mirëqenie për çdo lloj në të gjithë jetën e tij. Në mënyrë të veçantë:

a) Duhen mbajtur me kujdes femrat e mbarsura, gati në lindje apo ato që sapo kanë lindur për të përmbushur të gjitha kërkesat e tyre fiziologjike;

b) Llojet e reja që do të futen në kopshtin zoologjik të introduktohen (rifuten) gradualisht, në mënyrë që mos ketë probleme me ambientimin e tyre;

c) Vaskat për llojet detare duhen ajrosur duke mbajtur nën kontroll parametrat e ujit, i cili duhet të ketë standarde sanitare për të siguruar mirëqenien e llojeve;

d) Territoret e hapura të rrethuara me gardhe duhet të kenë strehime për të evituar shiun dhe diellin e fortë.

Neni 6

Ushqimi

1. Ushqimi dhe lëngjet duhet të kenë vlera ushqimore që t'i përgjigjen çdo individi të një lloji, duke pasur parasysh moshën, kushtet fizike dhe kushtet e përgjithshme shëndetësore.

2. Vëmendje të veçantë duhet të ketë për llojet, të cilat kanë trajtime mjekësore ose femrat gjatë kohës së mbarsjes.

3. Paketimi i ushqimeve duhet të kryhet në bazë të normave higjienike.

4. Duhet të ndalohet dhënia e ushqimeve nga vizitorët e parkut.

5. Ambientet e parkut duhen mbajtur në kushte higjieno-sanitare të përshtatshme (duke përdorur produkte jotoksike) në të gjithë territorin e zooparkut dhe vaskat për të zvogëluar rrezikun e transmetimit të sëmundjeve ngjitëse. Në rastin e vaskave me ujë duhet monitoruar cilësia kimike e ujit.

Neni 7

Kujdesi veterinar për kafshët

1. Në parqet zoologjike duhet që të ketë një asistencë veterinare.

2. Parku zoologjik duhet të ketë një program për kujdesin shëndetësor, i cili zbatohet në praktikë vetëm nën kujdesin e veterinerëve.

3. Nën kujdesin e mjekëve veterinerë duhet të kryhen analiza rutinë, të cilat përfshijnë kontrollin ndaj parazitëve dhe kryerjen e vaksinimit në mënyrë të rregullt për çdo individ.

4. Parqet zoologjike duhet të garantojnë një asistencë të mjekut veteriner 24 orë në 24, gjatë gjithë javës.

5. Parqet duhet të kenë një vend të caktuar për kujdesjen e kafshëve të lënduara, të sëmura apo të stresuara.

Neni 8

Protokolli pas ngordhjes së kafshëve

1. Kafshët e ngordhura duhet të menaxhohen në mënyrë të tillë që të parandalohet transmetimi i sëmundjeve ngjitëse te kafshët e tjera.

2. Shkaku i ngordhjes së kafshëve duhet të identifikohet gjithnjë nga veterineri dhe kjo praktikë duhet të kryhet nëpërmjet autopsisë nga mjeku veterinar apo nga mjeku patolog.

3. Pas kryerjes së autopsisë duhet të procedohet me mënyrë të shpejtë për heqjen e karkasës dhe të organeve të brendshme.

KREU IV
MBROJTJA DHE SIGURIA

Neni 9
Rrethimi me gardhe

1. Të gjitha llojet duhen mbajtur në territore të rrethuara me gardhe ose në kafaze, përfshirë edhe ato lloje të cilat nuk janë të rrezikshme.

2. Rrethimi i gardheve dhe kafazet duhet të projektohen, ndërtohen dhe të mirëmbahen në mënyrë të tillë që t'i përshtaten çdo lloji.

3. Llojet e rrezikshme të cilat mund të kapërcejnë gardhet duhet të mbahen në kafaze të mbyllura me rrjeta, me mure dhe me çati, në mënyrë të tillë që të pengohet kapërcimi i tyre nga lloje të rrezikshme.

4. Llojet brejtëse duhet të mbahen në kafaze ose në territore të rrethuara me gardhe, të cilat pengojnë largimin e tyre.

5. Rrjetat që rrethojnë gardhet duhet të jenë të salduara dhe të fiksuara mirë në tokë.

6. Portat e kafazeve që strehojnë lloje të rrezikshme duhet të mbyllen në mënyrë të sigurt.

7. Vaskat për llojet ujore duhet të jenë të projektuara për të parandaluar rrezikun, si për llojet e strehuara ashtu edhe për vizitorët.

Neni 10
Barrierat

1. Në zonat ku ekspozohen lloje të rrezikshme duhet të instalohet një barrierë ndarëse për vizitorët, për të parandaluar kontaktin e mundshëm.

2. Barrierat për vizitorët duhen ndërtuar në mënyrë të tillë që fëmijët e vegjël të mos e kalojnë apo të kapërcejnë gardhin.

Neni 11
Gardhet perimetrale

Gardhet perimetrale duhet të projektohen, ndërtohen dhe mirëmbahen, në mënyrë të tillë që të mos inkurajojnë vizitorët që t'i kapërcejnë ato. Asnjë gardh perimetral nuk duhet të jetë i elektrizuar ose të ketë një lartësi më të madhe se 2 metra.

KREU V
SINJALISTIKA DHE SIGURIA PËR VIZITORËT

Neni 12
Sinjalistika për vizitorët

1. Çdo territor i rrethuar me gardh dhe kafaz, që akomodon lloje të rrezikshme, duhet të ketë lajmërim me tabela të dukshme dhe me animacion e përmasa të përshtatshme, që paralajmërojnë për rrezikun e mundshëm dhe që të mos kapërcehet gardhi apo kafazi.

2. Çdo gardh i elektrizuar duhet të ketë tabelë të afishuar, e cila duhet të paralajmërojë vizitorët për rrezikun.

3. Tabelat e paralajmërimit duhet të jenë të afishuara si brenda ashtu dhe jashtë gardhit.

Neni 13
Largimi i llojeve nga kafazet

1. Operatorët e kopshtit zoologjik duhet të jenë të trajnuar për të mënjanuar rrezikun, i cili mund të vijë si pasojë e arratisjes së individëve të llojeve nga kafazet.

2. Në rastet e largimit të llojeve nga kafazi zbatohen planet e emergjencës.

Neni 14
Siguria për vizitorët

1. Ndërtesat, strukturat dhe zonat që vizitohen nga publiku duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme të sigurisë:

a) Vizitorëve u ndalohet hyrja në ndërtesa të cilat paraqesin rrezik për shëndetin apo për sigurinë e tyre;

b) Pemët në zonat ku vizitorët qëndrojnë apo ecin duhen kontrolluar, krasitur dhe prerë;

c) Pranë ambienteve ujore duhet të vendosen tabela informuese për të shmangur incidente të mundshme me vizitorët;

Neni 15
Emergjencat

1. Në parqet zoologjike, të cilat strehojnë lloje helmuese me qëllime konservimi (ruajtjeje), duhet të ruhen në mënyrë korrekte antihelmet, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë së tyre.

2. Personeli duhet të trajnohet për kryerjen e procedurave në raste kur vizitori pickohet nga lloje helmuese.

3. Trajnimi duhet të trajtojë:

a) Procedurën e menjëhershme të ndihmës së shpejtë për kurimin e pacientit (vizitorit);

b) Përshkrimin në detaje të zonës së pickimit dhe të llojit që ka pickuar vizitorin;

c) Emrin e antihelmit gjatë kohës së ndihmës së shpejtë.

KREU VI
KONTROLLI DHE INSPEKTIMI

Neni 16
Organet e kontrollit

1. Kontrolli dhe inspektimi i parqeve zoologjike duhet të kryhet të paktën një herë në vit nga organet inspektuese të ngarkuara me ligj.

2. Çdo zoopark mban bazën e të dhënave (*database*) të llojeve prezente që strehon, sipas formatit në shtojcën 1 bashkëlidhur kësaj rregullore.

3. Të dhënat e inspektimit për çdo zoopark, raportohen në Drejtorinë e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura pranë Ministrisë së Mjedisit dhe përditësohen rregullisht.

SHTOJCA 1

DETABASE I TË DHËNAVE NË PARQET ZOOLOGJIKE\ EMËRTIMI I PARKUT

NUMRI	EMRI NË LATINISHT\ SHQIP	MOSHA E INDIVIDËVE	GJINIA E INDIVIDËVE	NUMRI I MIKROCIPIT	KARTELA E VAKSINIMIT

VENDIM
Nr. 64, datë 15.9.2016

PËR PAJISJEN ME DEKODERA TË FAMILJEVE NË NEVOJË, PËRFITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Znj. Milva Ekonomi kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtar;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;
- Z. Petrit Bakiu anëtar;
- Z. Gramoz Hoxha anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 15.9.2016, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore" i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores "Për procedurat dhe formën e njoftimit", morri në shqyrtim "Planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike".

I. Procedura

1. Me shkresën nr. 1274, datë 12.2.2016, MZHETTS-ja i ka kërkuar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë njoftimin zyrtar të skemës së ndihmës shtetërore lidhur me VKM-në nr. 758/2015, si dhe vënien në dispozicion të çdo informacioni tjetër të nevojshëm për vlerësimin e saj.

2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë me shkresën nr. 929/1, datë 27.5.2016, ka paraqitur formularin bazë për njoftimin e ndihmave shtetërore duke përmbushur kërkesën ligjore për njoftimin e ndihmës shtetërore.

II. Përshkrimi i skemës së ndihmës shtetërore

3. Konteksti: Skema do të zbatohet në kuadër të projektit kombëtar të kalimit nga transmetimet analoge në transmetime numerike, ku krahas ndërtimit të rrjeteve është planifikuar pajisja[2] e audiencës me marrës numerikë ose dekoder (pajisja që konverton sinjalet numerike në sinjale analoge, për t'u kapur (marrë) nga aparatet marrëse të zakonshme analoge), që bëjnë të mundur përdorimin e marrësve ekzistues analogë edhe për marrjen e sinjaleve numerike.

4. Me anë të kësaj nisme garantohet e drejta kushtetuese e çdo qytetari shqiptar për t'u informuar nëpërmjet mediave audiovizive edhe pas dixhitalizimit të plotë të tyre, që rrjedh si detyrim i vënë nga Bashkimi Evropian për të kaluar të gjitha transmetimet televizive nga analoge në numerike.

5. Objektivi: Masa ka për qëllim të ofroj mbështetje për familjet në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike, për tu garantuar aksesin në transmetimet televizive, pas kalimit nga transmetime analoge në transmetime numerike. Masa ndërmerret me qëllim për të mbështetur futjen dhe përhapjen e teknologjisë dixhitale të transmetimit televiziv dhe zbatimin e saj në Shqipëri.

6. Baza ligjore: Skema për dhënien e mbështetjes financiare për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë është bazuar në:

a) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 758, datë 16.9.2015, "Për ngarkimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për kryerjen e procedurave të prokurimit për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike, dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për këtë ministri".

b) Neni 10, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar.

c) Vendim Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 2.5.2012, "Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike".

d) Vendim i Këshilli të Ministrave nr. 480, datë 3.6.2015, "Për miratimin e rregullave teknike për aparatet marrëse televizive, që do të vendosen në treg".

e) Udhëzimi nr. 5, datë 19.2.2016 i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë "Mbi zbatimin e vendimit nr. 758, datë 16.9.2015, të Këshillit të Ministrave për ngarkimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për kryerjen e procedurave të prokurimit për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike, dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për këtë ministri".

[2] Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 2.5.2012, "Për miratimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike"

7. Buxheti dhe mënyra e financimit: Ndihma parashikohet të jepet në formën e grantit nga buxheti i shtetit. Konkretisht, është caktuar një fond prej 170 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, që do të përdoret për kryerjen e procedurave të prokurimit për vitin 2015, dhe i është shtuar buxhetit të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Pjesa tjetër e fondeve, prej 180 000 000 (njëqind e tetëdhjetë milionë) lekësh do të përballohet nga buxheti i shtetit për vitin 2016.

8. Intensiteti i ndihmës: Intensiteti i ndihmës është në maksimum 100% të kostove të pranueshme. Kostoja e pranueshme përfaqëson çmimin e blerjes së pajisjes/dekoderit universalë dhe që siguron marrjen e sinjaleve standarde TV. Nga procedura e prokurimit ka rezultuar se çmimi për dekoder është 3,410 lekë (pa TVSH).

9. Kohëzgjatja: Skema e pajisjes me dekodera e familjeve në nevojë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike do të realizohet në mënyrë progresive, sipas zonave të përcaktuara nga Radio Televizioni Shqiptar të dërguara zyrtarisht pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimit Social Shtetëror, për shtrirjen e sinjalit dixhital, i cili do të zëvendësojë atë analog.

10. Përfituesit: Përfituesit direkt të skemës janë familjet në nevojë, personat fizik që trajtohen dhe përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, sipas nenit 10, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar. Numri i familjeve përfituese nga skema është 41.463. Përfitues indirekt do të jenë operatorët e transmetimeve televizive/broadcaster, operatorët e plafomave dixhitale (tokësore, satelitor, kabllor etj.), si dhe shitësit apo prodhuesit e pajisjeve fundore/dekoderave.

11. Shpërndarja e dekoderave: Pajisja me dekodera e familjeve në nevojë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike do të realizohet nga bashkitë në mënyrë progresive, sipas zonave të përcaktuara nga Radio Televizioni Shqiptar, për shtrirjen e sinjalit dixhital, i cili do të zëvendësojë atë analog. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë bën transferim kapitali të dekoderave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe kjo e fundit, lidh marrëveshje me bashkitë për shpërndarjen e dekoderave te familjet përfituese të skemës së ndihmës ekonomike si përdorues fundorë të këtyre pajisjeve.

12. Teknologjia: Subvencionimi do të bëhet vetëm për dekoderat që garantojnë përdorimin e të ashtuquajturës "ndërfaqe e përbashkët"[3]. Dekoderat që do të subvencionohen duhet të jenë universalë dhe duhet të kenë karakteristikat bazë për të siguruar marrjen e sinjaleve standarde TV. Modeli i dekoderit që do t'iu shpërndahet familjeve në nevojë është VIVAX, marrës DVB-T2/MPEG 4 F.T.A (*Free to Air*), dekoder, i cili do të transmetojë falas kanalet televizive që do përfshihen në këtë paketë. Pra, janë dekodera të thjeshtë, pa kartë, që lexojnë frekuencat e caktuara ku do transmetojnë kanalet e paketës të medias publike. Këta dekodera bëjnë të mundur transmetimin e kanaleve kombëtare publike apo private, si: TVSH, Top Channel, Klan, e kanale të tjera që do jenë të lira për t'u parë pa pagesë.

13. Prokurimi: Vendimi i KM-së nr. 758, datë 16.9.2015, ngarkon Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për kryerjen e procedurave të prokurimit për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike. Procedura e prokurimit do të kryhet në bazë të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar. Dhënësi i ndihmës ka konfirmuar se procedura e tenderit do të jetë e hapur[4] për çdo ofertues, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Përzgjedhja e fituesit do të bëhet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.[5]

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

14. Vlerësimi i kritereve që përcaktojnë nëse një masë përbën ndihmë shtetërore do të bëhet bazuar në ligjin nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, si dhe në praktikën administrative të

[3] "Ndërfaqe e përbashkët", një teknologji që lejon ndarjen e funksioneve të aksesit të kushtëzuar nga një aparat marrës televiziv, nëpërmjet një moduli të aksesit të kushtëzuar (CAM) për të mundësuar aksesin në disa sisteme enkriptimi që mund të ofrohen nga operatorë të ndryshëm.

[4] Buletini nr. 45, datë 16 nëntor 2015, f. 20, Agjencia e Prokurimit Publik

[5] Neni 2, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Komisionit Evropian[6], jurisprudencën e gjykatave të Bashkimit Evropian, sipas parashikime dhe detyrimit që buron nga nenin 71 "Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike", të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të Tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë:

"2. Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit."

15. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore nëse përmbushen, në mënyrë kumulative, këto kushte:

a) aktivizohen burime shtetërore;

b) përfituesit i jepet një avantazh ekonomik në mënyrë selektive; dhe

c) shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën

d) ka ndikim në tregti.

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore."

Burimet shtetërore

16. Komisioni i Ndihmës Shtetërore konstaton se skema financohet direkt nga buxheti i shtetit shqiptar dhe rrjedhimisht, aktivizohen burime shtetërore.

Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

17. Pavarësisht se, përfituesit direkt të skemës janë përdoruesit/konsumatorët fundor, nga kjo skemë përfitojnë, në mënyrë indirekte, operatorët e transmetimeve televizive/broadcaster, operatorët e platformave dixhitale (tokësore, satelitor, kabllor etj.), si dhe shitësit apo prodhuesit e pajisjeve fundore/dekoderave. Skema është selektive sepse prej saj përfitojnë vetëm ndërmarrjet që janë aktive në sektorin e transmetimeve televizive dixhitale. Masa i jep avantazh një sektori të veçantë/specifik dhe rrjedhimisht konsiderohet një masë specifike.

Shtrembërimi i konkurrencës

18. Përfituesit indirekt të skemës, siç janë operatorët e transmetimeve televizive/broadcaster, operatorët e plafomave dixhitale (tokësore, satelitor, kabllor etj.), si dhe shitësit apo prodhuesit e pajisjeve fundore/dekoderave do të përfitojnë nga blerja e pajisjeve fundore nga përdoruesit fundor, pavarësisht teknologjisë që ata ofrojnë në treg (parimi i neutralitetit të marrëseve dixhital). Konkurrenca midis ndërmarrjeve që përfitojnë dhe atyre që nuk përfitojnë nga skema do të shtrembërohet, rrjedhimisht kjo masë ka efekt në konkurrencë.

Efekti në tregti

19. Së fundi, Komisioni vlerëson së masa ka efekt në tregti sepse prodhuesit e pajisjeve terminale konkurrojnë në nivel ndërkombëtar edhe me prodhues të tjerë. Referuar jurisprudencës[7], ndihma e dhënë një ndërmarrje ka efekt në tregti, nëse kjo e fundit konkurron në një treg të hapur, sikundër është dhe rasti i sektorit të telekomunikimeve televizive.

Konkluzion

20. Sa më sipër, duke qenë se skema u jep një avantazh ekonomik selektiv, përfituesve direkt dhe indirekt, financohet direkt nga buxheti i shtetit, ka efekt në konkurrencë dhe tregti, Komisioni vlerëson se masa përbën ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

[6] State aid SA.36333 (2013/N) – Bulgaria Digital television decoders to households with low income;
State aid SA.34901 (2012/N) – Hungary Digital television decoders to socially disadvantaged households;
State aid N 316/2010 – Lithuania Switchover to digital TV broadcasting in Lithuania;
SA.32566 (2011/N) – Slovakia- Switch-over to digital TV broadcasting in Slovakia - Terminal equipment for socially vulnerable persons;
State aid SA.31982(2010/N) – Spain Digital decoders for persons ëith visual disabilities in Spain;
State aid N 719/2009 – Fonds destiné à certains foyers résidant dans des zones non couvertes par la télévision par voie hertzienne terrestre en mode numérique;

[7] Vendim i Gjykatës së Drejtësisë, 13 korrik 1988, 102/87 Francë vs Komisioni Evropian, ECR 1988, p. 4067

21. Masa konsiston në pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike. Pika 1, neni 7, i ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, parashikon se:

"Është e lejueshme:

1. Ndihma me karakter social dhe që jepet për individë, nëse kjo ndihmë është dhënë pa krijuar diskriminim lidhur me origjinën e produkteve në fjalë".

22. Një masë ndihme është e lejueshme nëse përmbush, njëherazi, tri kushte[8]:

a) Së pari, masa sjell një përfitim për individët. Ky kusht plotësohet, pasi përfitues direkt janë familjet në nevojë, pra individët/personat fizik, të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike.

b) Së dyti, masa duhet të ketë karakter social. Siç është shpjeguar në paragrafin 10, përfituesit direkt të skemës janë personat fizik që trajtohen dhe përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike. Nëse kjo kategori personash nuk do të përfitonte nga kjo masë, atëherë ata nuk do të ishin më në gjendje të merrnin sinjal televiziv dhe do të përjashtoheshin nga ky burim informacioni.

c) Së treti, masa nuk sjell diskriminim lidhur me origjinën e produkteve. Bazuar në informacionin e dhënë nga dhënësi i ndihmës, familjet në nevojë do të mund të përfitojnë vetëm dekodera me "ndërfaqe të përbashkët", universalë, duke respektuar "Parimin e neutralitetit teknologjik", që do të thotë se as imponon, as diskriminon në favor të përdorimit të një lloji të caktuar teknologjie.

23. Sa më lart, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se skema e ndihmës shtetërore është në përputhje me pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, pika 1, e nenit 7, nenit 17, neni 22, pika 2/1 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë skemën e dhënies së ndihmës shtetërore "Për pajisjen me dekodera të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike", si një skemë ndihme të lejueshme.

2. Të gjitha planet të cilat ndryshojnë masën e ndihmës duhet të njoftohen dhe marrin miratimin paraprak të KNSH-së.

3. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë brenda datës 31 mars të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE
Milva Ekonomi

VENDIM
Nr. 65, datë 15.9.2016

AUTORIZIM I DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE "PËR NXITJEN E PUNËSIMIT NË NDIHMË TË KRIJIMIT TË BIZNESIT SOCIAL RINOR"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Znj. Milva Ekonomi kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtar;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;
- Z. Petrit Bakiu anëtar;
- Z. Gramoz Hoxha anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 15.9.2016, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore" i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores "Për procedurat dhe formën e njoftimit", morri në shqyrtim Planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për nxitjen e punësimit në ndihmë të krijimit të biznesit social rinor".

I. Procedura

1. Bashkia Tiranë me shkresën nr. prot. 18807, datë 17.6.2016 në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, ka njoftuar pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (më poshtë "MZHETTS"), planin e ndihmës shtetërore "Për nxitjen e punësimit në ndihmë të krijimit të biznesit social rinor".

[8] Paragrafi 34, State aid SA.34901 (2012/N) – Hungary Digital television decoders to socially disadvantaged households

II. Përshkrimi i masës

2. Objektivi: Plani i ndihmës ka si objektiv të mbështes hapjen e bizneseve të reja nga sipërmarrës të rinj të moshës 20–35 vjeç, që ofrojnë një plan biznesi bindës dhe konkurrues, duke gjeneruar vende të reja pune. Plani parashikon mbështetjen me grante të projekteve novatore, fitimprurëse dhe që janë në përputhje me politikat e Bashkisë së Tiranës. Plani kontribuon në punësimin e personave të papunë, duke pasur në vëmendje edhe vajza e djem me aftësi të kufizuara, të cilëve jo vetëm u përmirëson standardin e jetesës por i bën të ndihen të vlefshëm për shoqërinë dhe pjesë e saj.

3. Baza ligjore për dhënien e ndihmës është:

a) Neni 24 i ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore";

"Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.

4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj."

b) Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 58, datë 30.1.2015, "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016–2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2016".

Buxheti Vjetor i Bashkisë Tiranë 2016

Programi 10140 "Kujdesi social dhe solidariteti"

4. Kohëzgjatja: Plani i ndihmës parashikohet të fillojë zbatimin në vitin 2016 dhe të zgjasë për një periudhë 3-vjeçare deri në vitin 2018.

5. Dhënësi i ndihmës dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia e Tiranës.

6. Përfituesit: Përfitues janë ndërmarrje të vogla ose shumë të vogla në territorin e Bashkisë së Tiranës, që zotërohen nga të rinjtë të moshës 18–35 vjeç. Projekti do të ketë kuota që kufizojnë numrin e aplikantëve dhe shumën e financimit për t'u përdorur për bizneset *start-up* dhe ato ekzistuese (50/50).

Secili aplikant mund të marrë pjesë vetëm me një ide biznesi. E drejta për të marrë pjesë në projekt dhe për të pasur akses në asistencën me grante mund të përdoret vetëm një herë në vit.

Projekti do të favorizoj ato ndërmarrje, të cilat janë në pronësi të të rinjve pjesë e grupeve të mëposhtme:

- të rinj /të reja (18–35 vjeç);
- të rinj nga zonat rurale të Bashkisë së Tiranës;
- të rinj me aftësi të kufizuara;
- të rinj dhe të reja, banore të qytetit të Tiranës, që janë në proces studimi në universitete publike apo jopublike (studentë/studente);
- të rinj dhe të reja të papunë që nuk u përkasin kategorive më lartë.

7. Shtrirja territoriale: Projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë së Tiranës.

8. Vlera e ndihmës/buxheti i planifikuar/ humbjet në buxhet: Fondi total i ndihmës në vitin 2016 është 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë, nga i cili do të shpallen 20 përfitues. Masa e financimit për individ/ndërmarrje do të jetë nga 500.000 lekë, për secilin plan biznesi të zhvilluar me sukses, i cili është pranuar gjatë procesit të përzgjedhjes, së bashku me asistencën për udhëheqje deri në dy vite pas fillimit të zbatimit të planit të biznesit. Aplikuesi duhet të ofrojë kontribut financiar të barasvlershëm me të paktën 20% të financimit të kërkuar me grant.

9. Intensiteti: Kostot e pranueshme që mund të mbulohen nga paratë e grantit duhet të përdoren për zbatimin e planit të biznesit dhe mund të përfshijnë:

- qiranë për mjediset për zyra dhe shërbimet e biznesit;
- blerjen e materialeve për mobilim ose rregullim të mjediseve/godinave për biznesin;
- blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve, si edhe software dhe asete të tjera jo të prekshme;
- blerjen para fillimit të materialeve të papërpunuara dhe produkteve të konsumueshme;
- rrogat dhe pagat, dhe shërbime të tjera të specializuara të nevojshme (kontabilitet, administrim, IT etj.);
- promovimin dhe reklamimin e aktiviteteve.

Ka disa kufizime për shpenzimet e pranueshme:

- deri në 30% të grantit mund të përdoret për

mobilim të mjediseve (deri në 50% lejohet vetëm për shërbime hotelerie);

- blerja e materialeve të papërpunuara mund të mbulohet vetëm një herë, si blerje e vetme e stokut fillestar;

- rrogat dhe pagat mund të mbulohen deri për gjashtë muaj pas fillimit të biznesit, bazuar në rrogën mesatare në Shqipëri (pjesa tjetër e rrogës duhet të mbulohet nga vetë biznesi);

- reklamimi mund të mbulohet vetëm për gjashtë muajt e parë pas fillimit, dhe nuk mund të tejkalojë më shumë se 10% të grantit total.

Shpenzimet jo të pranueshme që nuk mund të mbulohen nga paratë e grantit përfshijnë:

- blerjen e pasurive të patundshme (tokë, godina etj.);

- blerjen e mjeteve të transportit që nuk do të përdoren direkt për funksionimin e biznesit të propozuar;

- çdo shpenzim që nuk lidhet me biznesin e propozuar;

- shpenzimet e kryera përpara përmbylljes së kontratës së grantit.

Shpenzimet jo të pranueshme në grant mund të mbulohen nëpërmjet kontributit personal të aplikantit dhe formave të tjera të financimit, siç janë kreditë, huaja etj.

10. Forma e ndihmës dhe mjetet e financimi: Ndihma jepet në formën e grantit të drejtpërdrejtë. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij plani, përballohen nga buxheti i Bashkisë Tiranë për vitin 2016.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

11. Vlerësimi i kritereve që përcaktojnë nëse një masë përbën ndihmë shtetërore do të bëhet bazuar në ligjin nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, si dhe në praktikën administrative të Komisionit Evropian, jurisprudencën e gjykatave të Bashkimit Evropian, sipas parashikime dhe detyrimit që buron nga nenin 71 "Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike", të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të Tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë:

"2. Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit."

12. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen, në mënyrë kumulative, të gjitha këto kushte:

a) aktivizohen burime shtetërore;

b) përfituesit i jepet një avantazh ekonomik në mënyrë selektive; dhe

c) shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën;

d) ka ndikim në tregti.

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo lloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara".

Burimet shtetërore

13. Zbatimi i projektit aktivizon burime shtetërore, sepse financohet direkt nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

Bazuar në nenin 2, të ligjit nr. 9374/2005:

1. "Dhënës të ndihmës shtetërore" janë organet e pushteteve shtetërore dhe të qeverisjes vendore, si dhe çdo ent tjetër që vepron në emër të shtetit, të cilat mund ose janë të autorizuara të japin ndihmë shtetërore.

8. "Burime shtetërore" janë burimet e buxhetit të shtetit, përfshirë të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve, titujt shtetërorë, fondet publike, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, burimet e buxhetit të njësive të qeverisjes vendore, burimet e shoqërive shtetërore, në rastet kur këto burime nuk aktivizohen në përputhje me parimin e investitorit privat në një ekonomi tregu.

Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

14. Skema e ndihmës ka karakter selektiv, sepse prej saj përfitojnë vetëm një numër i kufizuar ndërmarrjesh mikro dhe të vogla, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në projekt vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë, dhe të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre tregtare në hapësirën territoriale administrative të Bashkisë Tiranë. Rrjedhimisht, jo të gjitha ndërmarrjet që operojnë në treg kanë aftësinë për të aplikuar dhe përfituar nga mbështetja financiare. Ndërmarrjet përfituese

kanë avantazh ekonomik, kundrejt ndërmarrjeve të tjera, pasi ato marrin nga bashkia një ndihmë financiare, që në kushte normale të zhvillimit të veprimtarisë së tyre nuk mund ta siguronin.

Shtrembërimi i konkurrencës dhe efekti në tregti

15. Masa e ndihmës ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se forcon pozitën ekonomike të ndërmarrjeve fituese kundrejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg.

Konkluzion

Sa më sipër, duke qenë se skema u jep ndërmarrjeve përfituese një avantazh ekonomik selektiv, financohet direkt nga buxheti i shtetit, ka efekt në konkurrencë dhe tregti, drejtoria vlerëson se masa përbën ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

Nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se:

Neni 8 i ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, parashikon se:

"1. Ndihma "*De minimis*" është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh."

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës "*De minimis*" përcakton vlerën maksimale të lejuar, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës "*De minimis*".

Kreu II i vendimit të KM-së parashikon:

1. Ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;

b) Ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Kreu III "Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit"

"1. Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente"

Sa më sipër bazuar në ligjin "Për ndihmën shtetërore" dhe vendimin e KM-së nr. 605/2016, ndihma "*De minimis*" lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon 14.000.000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet, pasi masa konsiston në dhënien e ndihmës financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në vlerën maksimale prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh për ndërmarrje.

b) Ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Kohëzgjatja e të gjithë skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është 3 vjet, duke plotësuar dhe kushtin tjetër ligjor.

c) Ndihma është transparente. Granti dhe subsida në të holla janë ndihmë transparente. Në rastin konkret, ndihma jepet në formën e grantit.

Nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, duke qenë në kushtet e përmbushjes së të gjitha kritereve të përcaktuara nga neni 8 Komisioni vlerëson se skema "Për nxitjen e punësimit në ndihmë të krijimit të biznesit social rinor" është një skemë ndihme që lejohet.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 8, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për nxitjen e punësimit në ndihmë të krijimit të biznesit social rinor".

2. Çdo plan ndihme, i cili ndryshon masën e ndihmës, lidhur me vlerën, kohëzgjatjen, ose kriteret duhet të njoftohet dhe të marrë miratimin e KNSH-së.

3. Bashkia e Tiranës brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

4. Bashkia e Tiranës të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KOMISIONIT
TË NDIHMËS SHTETËRORE
Milva Ekonomi

VENDIM
Nr. 66, datë 15.9.2016

PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE "PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË PËR PERIUDHËN 2016–2018"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Znj. Milva Ekonomi kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtar;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;
- Z. Petrit Bakiu anëtar;
- Z. Gramoz Hoxha anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 15.9.2016, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores "Për procedurat dhe formën e njoftimit", morri në shqyrtim "Planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë për periudhën 2016–2018"".

I. Procedura

1. Njoftimi i skemës është bërë pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm nga Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS).

II. Përshkrimi i skemës së ndihmës shtetërore

2. Konteksti: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në cilësinë e dhënësit të ndihmës shtetërore, dhe përgjegjës për hartimin e politikave ekonomike e tregtare në mbështetje të biznesit, me qëllim krijimin e kushteve lehtësuese dhe faciliteteve në rritjen e prodhimit dhe punësimit duke krijuar kështu bazat për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të vendit ka marrë nismën për krijimin e skemës së ndihmës "Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë për periudhën 2016–2018". Kjo skemë ndihme është në zbatim të Programit Strategjik të Qeverisë për të mbështetur fuqizimin e kompanive shqiptare me synim promovimin e produkteve "Made in Albania" globalisht, rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare, rritjen e punësimit, dhe përmirësimin në vazhdimësi të bilancit tregtar.

3. Kjo skemë ndihme vjen si rezultat i mbylljes në fund të vitit 2015 të Fondit ekzistues të Konkurrueshmërisë. Fondi i konkurrueshmërisë ka 9 vjet që është në shërbim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke asistuar ato nëpërmjet një skeme grant bazuar në ndarjen e kostove. Kjo mbështetje financiare ka ndikuar për të rritur konkurrueshmërinë e tyre në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë kontekst, vendimi i KNSH-së nr. 10, datë 2.2.2007, "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për grantin "Për krijimin e fondit shqiptar të Konkurrueshmërisë"", me anë të cilit është miratuar kjo skemë ka pushuar fuqinë juridike.

4. Objektivi: Skema e ndihmës ka si objektiv rritjen e aftësisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, për të konkurruar në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmjet rritjes së cilësisë së prodhimit e menaxhimit, integrimit të tyre dhe nxjerrjes së produkteve që të përmbushin kërkesat e standardeve të këtij tregu.

5. Baza ligjore: Baza ligjore për dhënien e ndihmës është:

a) Neni 6, shkronjat "a", "b", "c", "d" dhe "e", dhe neni 7, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar.

b) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 24, datë 20.1.2016 "Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë".

6. Buxheti dhe mënyra e financimit: Fondit Shqiptar i Konkurrueshmërisë ka një vlerë të përgjithshme prej 84 000 000 (tetëdhjetë e katër milionë) lekë, për periudhën 2016–2018. Vlera e fondit për secilin vit do të jetë 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i kësaj skeme, do të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s. Pagesa e subvencionit do të bëhet 50% me miratimin e projektit dhe 50% në fund të zbatimit të tij. Pagesa në fund të projektit do të bëhet kundrejt faturave të shpenzimeve të kryera për vlerën totale të projektit.

7. Intensiteti i ndihmës: Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë u jep ndihmë financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme deri në 70% të kostove të pranueshme por në asnjë rast jo më shumë se 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë. Në kostot e pranueshme që mund të bashkëfinancohen, përfshihen kostot, për:

a) përshtatje produkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin, certifikim produkti, vlerësim konformiteti dhe zbatim të sistemeve të menaxhimit të cilësisë;

b) pjesëmarrje në panaire jashtë vendit;

c) krijim faqeje interneti, zhvillim të tregtisë elektronike dhe promovim, publikim dhe hartim materialesh promovuese.

8. Kohëzgjatja: Skema parashikohet të fillojë zbatimin në vitin 2016 dhe të zgjasë për një periudhë 3-vjeçare, deri në vitin 2018.

9. Përfituesit: Përfitojnë nga Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) prodhojnë në Shqipëri produkte dhe/apo ofrojnë shërbime, të cilat tregtohen brenda dhe/apo jashtë vendit;

b) kanë selinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

c) kanë një strategji dhe plan marketingu;

d) janë në gjendje të financojnë 100 për qind të gjitha kostot e projektit, të propozuara para përfundimit të tij;

e) kanë paguar të gjitha detyrimet e parashikuara nga legjislacioni tatimor dhe doganor.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

10. Vlerësimi i kritereve që përcaktojnë nëse një masë përbën ndihmë shtetërore do të bëhet bazuar në ligjin nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, si dhe në praktikën administrative të Komisionit Evropian, jurisprudencën e gjykatave të Bashkimit Evropian, sipas parashikime dhe detyrimit që buron nga nenin 71 "Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike", të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të Tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë:

"2. Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.".

11. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen, në mënyrë kumulative, këto kushte:

a) aktivizohen burime shtetërore;

b) përfituesit i jepet një avantazh ekonomik në mënyrë selektive; dhe

c) shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën;

d) ka ndikim në tregti.

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo lloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.".

Burimet shtetërore

12. Komisioni i Ndihmës Shtetërore konstaton se skema financohet direkt nga buxheti i shtetit shqiptar (pika 8 e VKM-së nr. 24, datë 20.1.2016, "Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshnërisë") dhe rrjedhimisht, aktivizohen burime shtetërore.

Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

13. Skema e ndihmës ka karakter selektiv, sepse prej saj përfitojnë vetëm një numër i kufizuar ndërmarrjesh mikro, të vogla dhe të mesme, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 3 të VKM-së nr. 24/2016. Rrjedhimisht, jo të gjitha ndërmarrjet që operojnë në treg kanë aftësinë për të aplikuar dhe përfituar nga mbështetja financiare. Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, e cila miratohet nga ministri përgjegjës për ekonominë. Ndërmarrjet përfituese kanë avantazh ekonomik, kundrejt atyre ndërmarrjeve të tjera, pasi ato marrin nga shteti një ndihmë financiare, që në kushte normale të zhvillimit të veprimtarisë së tyre nuk siguronin.

Shtrembërimi i konkurrencës dhe efekti në tregti

14. Masa e ndihmës ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se forcon pozitën ekonomike të ndërmarrjeve fituese kundrejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg.

Konkluzion

15. Sa më sipër, duke qenë se skema u jep ndërmarrjeve përfituese një avantazh ekonomik selektiv, financohet direkt nga buxheti i shtetit, ka efekt në konkurrencë dhe tregti, Komisioni vlerëson se masa përbën ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

16. Neni 8 i ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, parashikon se:

"1. Ndihma "*De minimis*" është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh."

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës "*De minimis*" përcakton vlerën maksimale të lejuar, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës "*De minimis*".

Kreu II i vendimit të KM-së parashikon:

1. Ndihma lejohet nëse përmbushen njëherësh kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;

b) Ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Kreu III "Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit"

"1.Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente"

Sa më sipër bazuar në ligjin "Për ndihmën shtetërore" dhe vendimin e KM-së nr. 605/2016, ndihma "*De minimis*" lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon 14.000.000 (katërmbëdhjetë milion) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet, pasi masa konsiston në dhënien e ndihmës financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, në asnjë rast kjo ndihmë nuk mund të kaloj shumën e 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekë për ndërmarrje.

b) Ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Kohëzgjatja e të gjithë skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është 3 vjet, duke plotësuar dhe kushtin tjetër ligjor.

c) Ndihma është transparente, granti dhe subsida në të holla janë ndihmë transparente[9]. Në rastin konkret, ndihma jepet në formën e grantit.

17. Sa më lart, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se skema e ndihmës shtetërore është në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 8, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të miratojë skemën e dhënies së ndihmës shtetërore "Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë për periudhën 2016–2018", si një skemë ndihme të lejueshme.

2. Çdo plan ndihme, i cili ndryshon masën e ndihmës, lidhur me vlerën, kohëzgjatjen ose kriteret duhet të njoftohet dhe të marrë miratimin e KNSH-së.

3. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

4. AIDA të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE
Milva Ikonomi

[9] Neni 4, COMMISSION REGULATION (EU) No 1407/2013

VENDIM
Nr. 183, datë 6.9.2016

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E AMA-s, NR. 6, DATË 22.5.2013, "MBI MIRATIMIN E PAGESAVE PËR SHËRBIMET QË KRYHEN NGA AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE"

Në mbështetje të nenit 25, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pagesave për përpunimin administrativ të kërkesave për pajisje me licencë për rrjet numerik kombëtar, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 6, datë 22.5.2013, pika 2, në shumën si më poshtë:

- Operatorët numerikë të rrjeteve kombëtare: 500,000 lekë.

2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gentian Sala

VENDIM
Nr. 210, datë 16.9.2016

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 6, DATË 22.5.2013, "MBI MIRATIMIN E PAGESAVE PËR SHËRBIMET QË KRYHEN NGA AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE"

Në mbështetje të nenit 25, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pagesave për përpunimin administrativ të kërkesave për pajisje me licencë për rrjet numerik rajonal dhe lokal, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 6, datë 22.5.2013, i ndryshuar, në shumat si më poshtë:

- operator rrjeti numerik rajonal: 225,000 lekë;
- operator rrjeti numerik lokal: 112,500 lekë.

2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gentian Sala

KËRKESË
Nr. 4505, datë 20.9.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën "Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Korçë–Ersekë (loti 1)" për pasuritë e llojit "arë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit "arë". Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është 680 300 (gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e treqind) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM NË
MINISTRINË E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Ardit Kaja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve qe preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Korçë-Ersekë" Loti I

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr.Pas	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m2)	Sip. shpronës.	Çmimi (lek/m2)	Vlera totale (lek)	Shënime
1	Arqile	Vangjel	Zharkalli	1531	18/1	Arë	3900	181	100	18100	Konfirmuar ZVRPP
2	Sami	Isa	Ramolli	1531	18/2	Arë	5450	84	100	8400	Konfirmuar ZVRPP
3	Nuk ka informacion			1531	18/3			37	100	3700	Konfirmuar ZVRPP
4	Nuk ka informacion			1531	18/4			53	100	5300	Konfirmuar ZVRPP
5	Qamil	Nebi	Hasankolli	1531	16/1	Arë	2044	215	100	21500	Konfirmuar ZVRPP
6	Xhoxhi	Ligor	Shengjergji	1531	70/1	Arë	6437	367	100	36700	Konfirmuar ZVRPP
7	Agim	Ismali	Shahinlli	1531	70/2	Arë	4300	21	100	2100	Konfirmuar ZVRPP
8	Dhimo	Lija	Kapurani	1531	115/8	Arë	1900	61	100	6100	Konfirmuar ZVRPP
9	Nuk ka informacion			1531	115/9	Arë		79	100	7900	Konfirmuar ZVRPP
10	Jeras	Mihal	Kapurani	1531	115/10	Arë	2100	123	100	12300	Konfirmuar ZVRPP
11	Batiar	Veli	Ramolli	1531	115/11	Arë	3180	141	100	14100	Konfirmuar ZVRPP
12	Nikolla	Ilia	Kapurani	1531	115/14	Arë	2000	95	100	9500	Konfirmuar ZVRPP
13	Taqi	Nikolla	Kapurani	1531	115/15	Arë	2000	71	100	7100	Konfirmuar ZVRPP
14	Leonidha	Nikolla	Kapurani	1531	115/16	Arë	375	10	100	1000	Konfirmuar ZVRPP
15	Nuk ka informacion			1531	115/1			18	100	1800	Konfirmuar ZVRPP
16	Pellumb	Ymer	Pelivani	1531	115/2	Arë	4052	15	100	1500	Konfirmuar ZVRPP
17	Qani	Riza	Pelivani	1531	115/3	Arë	2125	16	100	1600	Konfirmuar ZVRPP
18	Qerim	bajram	Bekolli	1531	115/4	Arë	1930	42	100	4200	Konfirmuar ZVRPP
19	Bajram Fatbardha	Bexhet Ismail	Dushku Dushku	1531	115/5	Arë	1650	55	100	5500	Konfirmuar ZVRPP
20	Nikolla	Llambro	Kapurani	1531	115/6	Arë	4700	49	100	4900	Konfirmuar ZVRPP
21	Thodhoraq	Nasho	Marko	1531	114/1	Arë	6687	55	100	5500	Konfirmuar ZVRPP
22	Nuk ka informacion			1531	142/1			211	100	21100	Konfirmuar ZVRPP
23	Qerim	Bajram	Bekolli	1531	142/2	Arë	3062	133	100	13300	Konfirmuar ZVRPP
24	Hekuran	Bajram	Bekolli	1531	142/4	Arë	2625	102	100	10200	Konfirmuar ZVRPP
25	Nuk ka informacion			1531	142/7			96	100	9600	Konfirmuar ZVRPP
26	Haki		Mullaj	1531	275/3	Arë	625	211	100	21100	Konfirmuar ZVRPP
27	Lavdi	Sulo	Elezi	1531	9/1	Arë	810	83	100	8300	Konfirmuar ZVRPP
28	Sevet	Zenel	Elezi	1531	9/2	Arë	250	25	100	2500	Konfirmuar ZVRPP
29	Shaqir	Zenel	Elezi	1531	9/3	Arë	3870	250	100	25000	Konfirmuar ZVRPP
30	Servet	Zenel	Elezi	1531	9/4	Arë	1625	60	100	6000	Konfirmuar ZVRPP
31	Lavdi	Sulo	Elezi	1531	9/5	Arë	2625	46	100	4600	Konfirmuar ZVRPP
32	Panajot	Nasho	Xhavara	1531	9/6	Arë	3440	56	100	5600	Konfirmuar ZVRPP
33	Nuk ka informacion			1531	9/7			24	100	2400	Konfirmuar ZVRPP
34	Nuk ka informacion			1531	140/1			89	100	8900	Konfirmuar ZVRPP
35	Nuk ka informacion			1531	137/1			32	100	3200	Konfirmuar ZVRPP
36	Haki		Mullaj	1531	137/2	Arë	3562	35	100	3500	Konfirmuar ZVRPP
37	Joraz	Miho	Kapurani	1531	137/3	Arë	4187	46	100	4600	Konfirmuar ZVRPP
38	Jaraz	Miho	Kapurani	1531	137/5	Arë	3587	112	100	11200	Konfirmuar ZVRPP
39	Ethem Bashkim	Hamit Hamit	Metja Metja	1531	137/10	Arë	3400	4	100	400	Konfirmuar ZVRPP
40	Lisaveta Luljeta	Nevrus Hekuran	Metja Velija (Metja)	1531	137/13	Arë	1000	208	100	20800	Konfirmuar ZVRPP
41	Lisaveta Luljeta	Nevrus Hekuran	Metja Velija (Metja)	1531	280/6	Arë	2000	1075	100	107500	Konfirmuar ZVRPP
42	I paidentifikuar			1531	280/3	Arë		85	100	8500	Konfirmuar ZVRPP
43	Ardian	Ylli	Mete	1531	280/2	Arë	1052	970	100	97000	Konfirmuar ZVRPP
44	Mine Bashkim	Nasuf Safet	Pelivani Pelivani	1531	280/1	Arë	1062	1062	100	106200	Konfirmuar ZVRPP
	SHUMA							6803		680300	

KËRKESË
Nr. 4594, datë 23.9.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën "Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tiranë–Elbasan Loti III (shtesa)" për pasuritë e llojit "arë", "drufrutorë" dhe "kultura bujqësore".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit "arë", "drufrutorë" dhe "kultura bujqësore". Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është 4 722 087 (katër milionë e shtatëqind e njëzet e dy mijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM NË
MINISTRINË E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Ardit Kaja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "TIRANË- ELBASAN LOTI III(SHTESA)"

Nr.	Emri - Atesia - Mbiemri	Nr. Pasurise	Z.K	Are			Sere sip(m2)	Kult.bujq. drufrutore	Vlera totale	Shenime
				Sip.shp. m2	Çmimi	Vlera				
1	Bashkepronaret Terziu	.11/11	3371	1221	222	271062			271062	Certifikate pronesie
2	Gezim Kalem Drufi, Vjollca Kalem Islami, Bashkim Kalem Drufi, Zegjine Hysen Haka	266/1/1	2583	1180	222	261960		22300	284260	Certifikate pronesie Vleresuar D.R.B.E Nr.444,dt.17.08.2015
3	Lumturi Kole Ranxha, Evis Ndriçim Qosja, Mondi Ndriçim Qosja, Bledar Ndriçim Ranxha, Lavdia Hala, Mimoza Ndriçim Ranxha	.11/7	3371					11320	11320	Vleresuar D.R.B.E Nr.491,dt.10.09.2015
4	Ylber Peter Terziu	.11/31	3371	936	222	207792			207792	çertifikate pronesie
5	Besnik Mexhit Skora Dashamir Mexhit Skora Klodjana Qemal Cehu Nurije Mexhit Gega Sidorela Ylli Skora Klodjana Qemal Cehu	272/1	2583	1122	222	249084			249084	Certifikate pronesie
6	Bashkepronesi (Karai,Cani)	70/1	3674					61150	61150	Vleresuar D.R.B.E Nr.426,dt.05.08.2015
7	Ndriçim Gjika	.11/5	3371				680000	414000	1094000	Vleresuar D.R.B.E Nr.474,dt.03.09.2015
8	Marie Prokop Gega	17/8	3371					200300	200300	Vleresuar D.R.B.E Nr.479,dt.08.09.2015
9	Dhimiter Thanas Gega	.9/20	3371				120000	73980	193980	Vleresuar D.R.B.E Nr.492,dt.10.09.2016
10	Dhimiter Thanas Gega	16/3	3371					49200	49200	Vleresuar D.R.B.E Nr.809,dt.29.02.2016
11	Dejvis Ferit Dokoli Etleva Ferit Dokoli Hamide Qamil Dokoli Ndricim Selman Dokoli Qerime Selman Dokoli Refik Selman Dokoli Shyqyri Selman Dokoli Zegjine Selman Hasa Vjollca Ferit Dokoli Xhilberta Ferit Kacanolli	1364	2583					77100	77100	Vleresuar D.R.B.E Nr.2303,dt.10.11.2015
12	Bashkepronesi (Enver Sulaj etj.)	79/23	3674					284700	284700	Vleresuar D.R.B.E Nr.2669,dt.23.11.2015
13	Vasil Preni	.11/32	3371					10185	10185	Vleresuar D.R.B.E Nr.3088,dt.15.12.2015
14	Vasil Preni	.11/36/1	3371					25900	25900	Vleresuar D.R.B.E Nr.3088,dt.15.12.2015
15	Xhemal Reshat Taçi	1314;1312	2583					76200	76200	Vleresuar D.R.B.E Nr.457,dt.01.02.2016
16	Jani Doka	.11/19	3371					33700	33700	Vleresuar D.R.B.E Nr.2951,dt.09.12.2015
17	Deje Nuredin Meta Jonuz Sabri Meta	79/46	3674	622	222	138084			138084	Certifikate pronesie
18	Qerim Kalem Allhasa	106/6/1	3419					248120	248120	Certifikate pronesie
19	Aleks Toçi	61/22/1	1258					1073300	1073300	Vleresuar D.R.B.E
20	Spiro Gjika	.11/39	3371					21350	21350	Vleresuar D.R.B.E nr.946,dt.09.03.2016
21	Lorenc Stavri Doko	36/20	3371					111300	111300	Vleresuar D.R.B.E nr.1458,dt.13.04.2016
	Shuma totale								**4722087**	

KËRKESË
Nr. 4595, datë 23.9.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën "Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga rikonstruksioni i aksit rrugor "Shkodër–Mes" për pasuritë e llojit "truall" dhe "arë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit "truall" dhe "arë". Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është 2 906 222 (dy milionë e nëntëqind e gjashtë mijë e dyqind e njëzet e dy) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM NË
MINISTRINË E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Ardit Kaja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që preken nga "Rikonstruksioni I aksit rrugor Shkodër-Mes"

N/R	PRONARI			Zona Kad.	Numri Pasurisë	Lloji Pas.	ARE			TRUALL			Vlera Totale lekë	Shënime
	Emri	Atesia	Mbiemri				Sip. Shpron.	Çmimi (m2)	Vlera lekë / m2	Sip. Shpron. Truall	Çmimi (m2)	Vlera lekë / m2		
1	Beqir	Man	Zalli (BP.)	8593	117/86	Truall				203	8511	1727733	1727733	Proc.Regj
2	Frang	Kolë	Pali	1790	112/6	Arë	62	270	16740				16740	Çertif. Pron.
3	Ipa Identifikuar			1790	112/7,	Arë	323	270	87210				87210	Proc.Rikonf.
4	Ipa Identifikuar			1790	112/8,	Arë	234	270	63180				63180	Proc.Rikonf.
5	Lazër		Vata	1790	112/4,	Truall				89	421	37469	37469	Proc.Rikonf.
6	Ipa Identifikuar			1790	112/5,	Arë	62	270	16740				16740	Proc.Rikonf.
7	Ipa Identifikuar			1790	112/2	Arë	215	270	58050				58050	Proc.Rikonf.
8	Ipa Identifikuar			1965	548/1	Arë	54	270	14580				14580	Proc.Rikonf.
9	Fatmir	Sabri	Mehaj	1965	548/18	Arë	36	270	9720				9720	Çertif. Pron.
10	Ipa Identifikuar			1965	548/4	Arë	43	270	11610				11610	Proc.Rikonf.
11	Prenda Flora	Pjetër Lekë	Çuni Çuni	1965	548/14	Arë	327	270	88290				88290	Çertif. Pron.
12	Ipa Identifikuar			1965	549	Arë	344	270	92880				92880	Proc.Rikonf.
13	Ipa Identifikuar			1965	540/1	Arë	46	270	12420				12420	Proc.Rikonf.
14	Ipa Identifikuar			1965	540/16	Arë	52	270	14040				14040	Proc.Rikonf.
15	Ipa Identifikuar			1965	540/14	Arë	47	270	12690				12690	Proc.Rikonf.
16	Ipa Identifikuar			1965	540/20	Arë	70	270	18900				18900	Proc.Rikonf.
17	Ipa Identifikuar			1965	540/8	Arë	93	270	25110				25110	Proc.Rikonf.
18	Ipa Identifikuar			1965	540/9	Arë	108	270	29160				29160	Proc.Rikonf.
19	Ipa Identifikuar			1965	540/30	Arë	274	270	73980				73980	Proc.Rikonf.
20	Gjergj	Lulash	Preka	1240	553/1	Arë	50	270	13500				13500	Proc.Rikonf.
21	Hasan		Karmaj	1240	527/11	Arë	293	270	79110				79110	Çertif. Pron.
22	Hasan		Karmaj	1240	527/111	Arë	81	270	21870				21870	Çertif. Pron.
23	Petrit	Hasan	Karmaj	1240	527/112	Arë	50	270	13500				13500	Çertif. Pron.
24	Petrit	Hasan	Karmaj	1240	527/113	Arë	66	270	17820				17820	Çertif. Pron.
25	Petrit	Hasan	Karmaj	1240	527/114	Arë	22	270	5940				5940	Çertif. Pron.
26	Ipa Identifikuar			1240	527/115	Arë	75	270	20250				20250	Proc.Rikonf.
27	Ipa Identifikuar			1240	527/16	Arë	46	270	12420				12420	Proc.Rikonf.
28	Ipa Identifikuar			1240	527/13	Arë	75	270	20250				20250	Proc.Rikonf.
29	Ipa Identifikuar			1240	527/69	Arë	40	270	10800				10800	Proc.Rikonf.
30	Ipa Identifikuar			1240	52778	Arë	127	270	34290				34290	Proc.Rikonf.
31	Ipa Identifikuar			1240	527/79	Arë	48	270	12960				12960	Proc.Rikonf.
32	Ipa Identifikuar			1240	527/75	Arë	55	270	14850				14850	Proc.Rikonf.
33	Ipa Identifikuar			1240	527/72	Arë	99	270	26730				26730	Proc.Rikonf.
34	Ipa Identifikuar			1240	527/73	Arë	46	270	12420				12420	Proc.Rikonf.
35	Ipa Identifikuar			1240	527/74	Arë	64	270	17280				17280	Proc.Rikonf.
36	Ipa Identifikuar			1240	527/2	Arë	45	270	12150				12150	Proc.Rikonf.
37	Ipa Identifikuar			1240	527/1	Arë	48	270	12960				12960	Proc.Rikonf.
38	Ipa Identifikuar			1240	527/3	Arë	47	270	12690				12690	Proc.Rikonf.
39	Ipa Identifikuar			1240	527/99	Arë	299	270	80730				80730	Proc.Rikonf.
40	Ipa Identifikuar			1240	67/3	Arë	44	270	11880				11880	Proc.Rikonf.
41	Klodjana		Kapllani	1240	67/33	Arë	29	270	7830				7830	Çertif. Pron.
42	Asllan		Spahija	1240	67/32	Arë	36	270	9720				9720	Proc.Rikonf.
43	Hamdi		Spahija	2665	34/25	Arë	25	270	6750				6750	Proc.Rikonf.
44	Klodjana		Kapllani	2665	34/24	Arë	13	270	3510				3510	Çertif. Pron.
45	Klodjana		Kapllani	2665	34/23	Arë	13	270	3510				3510	Çertif. Pron.
SHUMA							4226		1141020	292		1765202	2906222	

KËRKESË
Nr. 4626, datë 26.9.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën "Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Nyja lidhëse Milot–Lezhë, Milot–Rrëshen, Milot–Thumanë" për pasuritë e llojit "objekt", "arë" dhe "kultura bujqësore".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit "objekt", "arë" dhe "kultura drufrutore". Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është 4 430 550 (katër milionë e katërqind e tridhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM NË
MINISTRINË E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Ardit Kaja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "NYJA LIDHËSE MILOT -LEZHË, MILOT- RRËSHEN, MILOT-THUMANË"

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastr.	Numri Pasurisë	Sip. Totale	Siperfaqe e shpronesuar sipas VKM nr.511,date 10.06.2015	TOKE ARË			OBJEKT		Vlera e kulturave bujq. dhe drufrut. (Lekë)	VLERA TOTALE (LEKE)	Shënime
								Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera lekë	Sip. ndert (m2)	Vlera (Lekë)			
1	Mark	Gjon	Tarazhi	1677	29/54	3370	3370						471,000	471,000	Konfirmuar nga DRBL
2	Gjon	Preng	Tarazhi	3441	.3/27	3456	3256						518,600	518,600	Konfirmuar nga DRBL
3	Gjon	Preng	Tarazhi	3441	2/1-ND						120	3,212,434		3,212,434	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Dile	Gjin	Gjeta	3441	3/28	822		822	278	228,516				228,516	Certifikate Pronesie
	SHUMA TOTALE													4,430,550	

KËRKESË
Nr. 4627, datë 26.9.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën "Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Nyja Rrugore Vorë" për pasuritë e llojit "arë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që

shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit "arë". Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është 469 952 (katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM NË
MINISTRINË E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Ardit Kaja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që preken nga ndërtimi I segmentit rrugor "Nyja Rrugore Vorë"

Nr.	Pronari			Z.K.	NR.PAS	Lloji i Pasurisë	Sip.totale (m2)	Sip. e shpronësimit (m2)	Çmimi (lek/m2)	Vlera totale (lek)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Mustafa	Idriz	Ismaili	2596	36/2	Arë	2100	237	448	106176	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Qazim	Ali	Ismaili	2596	36/3	Arë	1380	190	448	85120	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Rexhep	Islam	Ismaili	2596	36/8	Arë	1450	175	448	78400	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Abaz	Islam	Ismaili	2596	36/14	Arë	500	40	448	17920	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Abaz	Islam	Ismaili	2596	36//15	Arë	950	149	448	66752	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Besnik	Xhemal	Ismaili	2596	36/13	Arë	625	106	448	47488	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Sefer	Islam	Alvora	2726	38/23	Arë	2600	152	448	68096	Konfirmuar nga ZVRPP
	SHUMA TOTALE							1049		**469952**	

KËRKESË
Nr. 4041/2, datë 23.9.2016
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerim dhe rikonstruksion i bulevardit "Fan Noli", në Bashkinë e Korçës.

Subjekti kërkues është Bashkia e Korçës.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 702 083 (shtatëqind e dy mijë e tetëdhjetë e tre) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË SË
PUNËVE TË BRENDSHME
Elona Gjebrea

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit "Zgjerim dhe rikonstruksion i bulevardit "Fan Noli", në Bashkinë e Korçës

Nr, Rendor	Emër Atësia Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr. Pasurie	Lloji i Pas.	Truall. (m2) ZVRPP	Sip. e cila shpronësohet	Çmimi lekë/ m²	Vlera totale e shpronësimit	Vërtetim nga ZRPPP
1	Riza Kollel Kalemi Pranvera Veliu Aferdita Veliu Gazmend Veliu	8564	1/39	T+ND	534.0 m^2 – 179.8 m^2	82.24	8537	702 083	Konfirmim nga ZRPPP
	Totali							**702 083**	

KËRKESË
Nr. 5113, datë 20.9.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Kompleksi Sportiv Lushnja" qyteti Lushnjë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personin, i cili preket nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 37, 964, 960 (tridhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

SHPRONËSIMI

Objekti: Këndi sportiv në lagjen "Skënder Libohova"
Zona kadastrale 8572, Lushnjë

Nr	Nr.pas	Zona Kadastrale	Lagja	Emer Mbiemer	Lloji	m2	Cmimi	Vlera	Konfirmimi I ZVRPP-se
1	9/95	8572	S.Libohova	Shefqet Dervishi +bashkepronare	Truall	4240	8954	37964960	
						Totali		37964960	

KËRKESË

Shtetasja Luljeta Tarko, e bija e Xhebarit dhe e Nadires, e datëlindjes 25.5.1959, lindur në Vlorë dhe banuese në Durrës, kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, shtetasit Feti Shyqyri Tarko, i datëlindjes 30.12.1053 dhe emërimin si kujdestare e posaçme e pasurisë së tij.

KËRKUESE
Luljeta Tarko

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot"
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë